



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. _____ prot.

Himarë , më _____.____.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “RIKONSTRUKSIONI I KOPËSHTIT DHE ÇERDHES, HIMARË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për kopështe femijësh **45214100-1**

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës **25,000,000** (njeyete e pese milione) lekë **pa TVSH** ,
vënë në dispozicion nga **buxheti i Bashkisë Himarë** .

Perilogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit / kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në

procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar’’. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, dhe 2025**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar’’. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar edhe në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2025** dhe **2026** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- i. Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:*
- ii. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- iii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iv. Faturat Tatimore të miratuar sipas legjislacionit tatimor*
- v. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- vi. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

a) **Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat:** Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- viii. Kontratën e Sipërmarrjes,*

- ix. *Situacionin përfundimtar të objektit*
- x. *Aktin e Kolaudimit të objektit*
- xi. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**
- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- NP.1 –Punime Germimi ne toke **Klasifikimi A**
- NP.3 – Rikonstrukcion e mirembajtje godinash **Klasifikimi A**

- **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- NS- 2 – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre **Klasifikimi A**
- NS- 4 – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to **Klasifikimi A**
- NS- 12 – Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit **Klasifikimi A**
- N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV **Klasifikimi A**
- NS- 18 –Punime topogjeodezike **Klasifikimi A**

* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”,neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Punime gërmim dheu, Punime prishje, Punime gërmim shkëmbi i fortesive të ndryshme me ekskavator. Sipas kapitullit 9. Te preventivit NENSHTRESA DHE SHTRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE Zerit Nr. 2.114 Plinta e	A	0-21 milion

		bazamente b/a monolite deri 20m3 C 16/20		
NP-3	Rikonstruksion e mirembajtje godinash	Punime per rikonstruksioni e objektit,suvatime,hidroizolimi,illustra,dyer ,dritare,çati,punime gipsi.	B	21-50 milion
NS-2	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Punime ne object per sistemin e furnizimit me uje dhe instalit te paisjeve hidrosanitare,furnizim te mbrojtjes nga zjarri,shkarkimin e ujrave te zeza.	A	0-21 milion
NS-4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to	Punime rifiniture ne objektin per rikonstruksion,pllaka,ulluqe,murature,patin ime,ljerje me boje,punime termoizolimi.	A	0-21 milion
NS-12	Impiante teknologjik,termike dhe te kondicionimit	Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, Sipas yerave te preventivit	A	0-21 milion
NS-14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV	Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Sipas zerave te preventivit	A	0-21 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Rilevim topografik,piketim per rrugen,sheshin.	A	0-21 milion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** (*Sistemi Menaxhimit te Cilesise*)
- **ISO 14001:2015** (*Sistemi Menaxhimit Mjedisor*)
- **ISO 45001:2021** (*Sistemi i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune*)
- **ISO 50001-2018**, (*Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent*)
- **ISO 3834:2:2021** (*Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim e vlefshme ose ekuivalent*)

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikatat e mesiperme sipas natyres se punimeve

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, si dhe nenit nr. 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020“Për prokurimin publik” dhe bazuar ne nenin 44 pika 1, e VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardete kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, te ndryshuar, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Duke qenë se përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi është Autoriteti Kontraktor,gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar”.

- Për ISO 9001 - 2015; Kjo çertifikate specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një operator ekonomik duhet të tregojë aftësinë e tij që vazhdimisht të sigurojë punë/mallra ose shërbime që plotësojnë kërkesat e aplikueshme ligjore dhe rregullatore, si dhe synon të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit duke përfshirë edhe proceset për përmirësim të vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit të klientit dhe kushtet e aplikueshme ligjore dhe rregullatore si dhe meqënëse Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon që punimet që do të kyhen të jenë në cilësinë më të lartë është përcaktuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me këtë standart cilësie.

- Per ISO 14001 – 2015: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 14001 – 2015, standart ky që vlerëson sipas përkufizimit të tij përgjegjshmërinë e kompanive ndaj mjedisit. Standardet e Sistemit të Menaxhimit - që vlerësojnë nivelin e sistemit të zhvillimit dhe integritetit të përgjegjësive ndaj mjedisit në të gjithë kompaninë. Bashkia Selenice si Autoritet Kontraktor kërkon një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore.

- Per ISO 45001:2018: Eshtë kërkuar që kandidatët ofertues të jenë të pajisur me standartin ISO 45001:2018, standart ky qe përcakton kërkesat minimale të shëndetit në punë dhe praktikat më të mira të menaxhimit të sigurisë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shendetësor optimaldhe menaxhimin e sigurisë në punë. Kjo mund te ndihmojë per të vënë në vend politikat,procedurat dhe kontrollet e nevojshme për cdo lloj biznesi për të arritur kushtet më të mira të mundshme të punës, një linjë me praktikën më të mirë të njohur ndërkombëtare

- ISO 50001:2018, ISO 50001:2018 përfaqëson një standard ndërkombëtar të njohur për Sistemin e Menaxhimit të Energjisë, i cili synon përmirësimin e performancës energjetike, reduktimin e konsumit të energjisë dhe optimizimin e përdorimit të burimeve gjatë realizimit të proceseve teknike dhe operative. Vendosija e këtij kriteri është e justifikuar në mënyrë të posaçme në rastet kur kontrata përfshin:

përdorim intensiv të mjeteve dhe makinerive të rënda;
procese ndërtimore me konsum të lartë energjie;

operime në kantier me ndikim të konsiderueshëm mjedisor dhe energjetik;
nevojën për menaxhim të qëndrueshëm të burimeve gjatë zbatimit të projektit.
Certifikimi ISO 50001:2018 garanton që operatori ekonomik:

ka implementuar procedura të strukturuar për monitorimin dhe uljen e konsumit të energjisë;
siguron përdorim efikas të makinerive dhe pajisjeve në kantier;
minimizon humbjet energjetike dhe kostot operative;
në uljen e ndikimit mjedisor të aktivitetit ndërtimor.

Kërkesa që certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i akredituar nga një organizëm kombëtar ose ndërkombëtar i njohur nga Republika e Shqipërisë synon të garantojë besueshmërinë, vlefshmërinë dhe njohjen zyrtare të certifikimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të akreditimit.

Ky kriter është proporcional me objektin e kontratës, i lidhur ngushtë me natyrën e punimeve dhe përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve me konsum të lartë energjie, si dhe nuk ka karakter diskriminues, pasi ISO 50001 është një standard i hapur dhe i aksesueshëm nga të gjithë operatorët ekonomikë në treg.

- Per ISO3834-2:2021 (Sistemet e menaxhimit të saldimit) Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, ku proceset e saldimit përbëjnë një komponent thelbësor të realizimit të punimeve, zbatimi i standardit ISO 3834-2:2021 (“Kërkesa për cilësinë në saldim të materialeve metalike – Kërkesa të plota për cilësi”) paraqet një domosdoshmëri teknike dhe organizative. Ky standard përfaqëson nivelin më të plotë të menaxhimit të cilësisë në proceset e saldimit dhe është kritike për të garantuar:

Sigurinë strukturore dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të punimeve, përmes përdorimit të procedurave të kualifikuara të saldimit (WPS), saldatorëve të certifikuar dhe pajisjeve të monitoruara teknikisht.

Përputhshmërinë me kërkesat e standardeve të tjera ndërkombëtare dhe ligjeve teknike në fuqi, si p.sh. EN 1090, PED 2014/68/EU, direktiva për pajisje nën presion, etj.

Minimizimin e gabimeve teknike dhe kostove të riparimit, duke siguruar kontroll të plotë dhe dokumentim të çdo faze të procesit të saldimit.

Rritjen e besueshmërisë dhe transparencës së operatorit ekonomik, duke garantuar se proceset e prodhimit janë të kontrolluara sipas kërkesave të standardit më të lartë të disponueshëm në fushën e saldimit.

Zbatimi i ISO 3834-2 është veçanërisht i rëndësishëm për projekte që përfshijnë:

Prodhimin ose montimin e konstrukcioneve metalike

Përdorimin e pajisjeve të salduara nën presion

Punime me ngarkesa dinamike ose në mjedise me rrezik të lartë

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **40 (dyzete) punonjës**, me kohë të plotë pune, për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.

2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **40 (dyzete)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit. Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të permbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje për 3 (tre) muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave j, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përse kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 65 persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .Bazuar në kriter elementet e strukturës së kostos(material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, librezë pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6, stafi inxhinierik si më poshtë:

- Minimuni **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- Minimuni **1 (një) Inxhinier Gjeodet/ Markshejder**

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin

me sukses të kontratës.” Kërkesa per 1 (një) punonjës Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. **Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

1.Inxhinier Hidroteknik, i domosdoshëm për punimet, është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave hidroteknike, etj. Duke përfshirë por mos përjashtuar instalimet hidroteknike, kanalizim kryesor.

2.Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, duke siguruar zbatimin e saktë të projektit dhe duke pasur parasysh Specifikimet Teknike dhe projektin e miratuar.

3.Inxhinier Elektrik, është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zerave elektrike, etj. Ai do të kryej kontrole gjate punimeve, testet ne perfundim të kërkuara sipas specifikimeve teknike dhe do të garantojë suksesin e investimit. Konkretisht kapituajt e preventivit ne lidhje me punimet elektrike, instalime te pajjeve teknologjike ngrohese si dhe analizat e bazuara në projekt.

4.Inxhinier Gjeodet/ Markshejder, është përgjegjës për dhe do të kryejë azhornimin topografik dhe piketimin e objektit ndërtimor, si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bejë edhe azhornimin faktit (as built). Ky inxhinier është i nevojshem për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe

nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave të preventivit të punimeve, si më poshtë:

– Teknik i mesem Ndërtimi (Diplome e shkolles mesme)	– jo me pak se 1 (një)
– Teknik i mesem Topograf (Diplome e shkolles mesme)	– jo me pak se 1 (një)
– Teknik i mesem Mekanik (Diplome e shkolles mesme)	– jo me pak se 1 (një)
– Betonues (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Hekurkthyes (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Murator/Suvatues (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Punonjes D/Alumini (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Bojaxhi (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Punonjes Konstruksiune Mekanike (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Hidrozolues/Punonjes Catie (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Pllakashtrues (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Termoizolues (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Elektracist (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Hidraulik (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Specialist kapote ETICS / EPS (Me Certifikate Trajnimi / Diplome)	- jo me pak se 2 (dy)
– Punonjës të specializuar përpunimet në lartësi (“Punime në skela”)	- jo me pak se 2 (dy)

Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale (të vlefshme).
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Per punonjesit teknik/ndertimi/topograf/elektracist/elektromekanik diplome të shkollës së mesme profesionale si dhe te jene te paisur me ,Dëshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje trup çertifikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Te gjithë punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listepagesat të shoqërisë minimalisht për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga hapja e ofertave.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit për diplomën/certifikatën përkatëse si dhe emrin e institucionit që ka leshuar dokumentin për specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Stafi teknik (Teknik i mesëm)

Kërkesa për të paktën:

1 Teknik i mesëm Ndërtimi

1 Teknik i mesëm Topograf

1 Teknik i mesëm Mekanik

është e domosdoshme për:

drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve në kantier;
sigurimin e zbatimit korrekt të projektit dhe standardeve teknike;
realizimin e matjeve topografike dhe kontrollit të kuotave dhe niveleve;
mirëmbajtjen dhe funksionimin e mjeteve dhe pajisjeve mekanike.

Punonjës të specializuar për punime ndërtimore

Kërkesa për numrin minimal të punonjësve të specializuar në fusha të ndryshme (betonues, hekurkthyes, murator/suvatues, bojaxhi, punonjës alumini, konstruksione mekanike, hidroizolues, pllaka shtrues, termoizolues, elektrik, hidraulik, specialist ETICS/EPS) është vendosur për të garantuar:

realizimin e të gjitha zërave të punimeve sipas preventivit;
cilësinë teknike të punimeve strukturore dhe përfundimtare;
respektimin e standardeve të ndërtimit dhe sigurisë teknike;
ndarjen e qartë të detyrave sipas profilit profesional;
shmangien e vonesave dhe ndërprerjeve në procesin e zbatimit.

Punonjës për punime në lartësi

Kërkesa për të paktën 5 (pese) punonjës të specializuar për punime në lartësi (punime në skela) është vendosur në funksion të:

garantimit të sigurisë në punë në përputhje me VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për sigurinë në kantier”;

reduktimit të rrezikut të aksidenteve gjatë punimeve në lartësi;

sigurimit të përdorimit korrekt të pajisjeve mbrojtëse individuale (DPI);
ritjes së eficiencës dhe kontrollit në punimet në struktura të ngritura.

Kërkesa për kualifikim dhe certifikim profesional

Kërkesa që punonjësit të jenë të pajisur me **diploma dhe/ose certifikata trajnimi** synon të garantojë që personeli i angazhuar:

- zotëron aftësi profesionale të verifikuara;
- është i trajnuar sipas standardeve bashkëkohore të ndërtimit;
- siguron cilësi dhe qëndrueshmëri në realizimin e punimeve;
- kontribuon në ritjen e sigurisë dhe profesionalizmit në kantier.

Parimi i proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit

Këto kërkesa janë vendosur në respektim të plotë të parimit të proporcionalitetit, duke qenë drejtpërdrejt të lidhura me natyrën dhe volumin e punimeve objekt kontrate.

Ato nuk kanë karakter kufizues apo diskriminues, pasi:

- kërkojnë standarde profesionale të zakonshme në sektorin e ndërtimit;
- nuk imponojnë certifikime ekskluzive;
- janë të arritshme nga operatorët ekonomikë aktivë në tregun e ndërtimit;
- synojnë vetëm garantimin e cilësisë dhe sigurisë së zbatimit të kontratës.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- a) 1 (një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "Për sigurinë në kantier", VKM-së Nr.108, dt 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1.a dhe 1.b, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga

rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- b) **1 (një) punonjës** të disponojë certifikatë “Ekspert Zjarrfikës” në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Për këtë duhet të paraqitet Certificate/dëshmi për ekspert zjarrfikës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, diploma dhe kontrata noteriale e punës/kontrate bashkëpunimi.”

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Ekspert Zjarrfikës”, në përputhje me pikën 4 të nenit 49 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, është vendosur në funksion të garantimit të zbatimit të kërkesave ligjore dhe teknike që lidhen me mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë e objekteve gjatë realizimit të kontratës.

Objekti i kontratës përfshin punime dhe instalime për të cilat është e nevojshme vlerësimi dhe mbikëqyrja e masave të mbrojtjes nga zjarri, me qëllim që zgjidhjet teknike të zbatuara të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi, normat teknike dhe standardet e sigurisë.

Prania e një eksperti të certifikuar zjarrfikës garanton:

verifikimin e përputhshmërisë së punimeve me kërkesat e mbrojtjes nga zjarri;
identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të cenojnë sigurinë e objektit dhe përdoruesve të tij;
zbatimin korrekt të masave parandaluese dhe mbrojtëse ndaj rrezikut të zjarrit;
asistencën teknike gjatë realizimit të punimeve dhe koordinimin me institucionet kompetente kur kjo kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Kërkesa që certifikata/dëshmia të jetë e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, si autoriteti përgjegjës për certifikimin e ekspertëve të mbrojtjes nga zjarri, synon të garantojë vlefshmërinë ligjore dhe kompetencën profesionale të specialistit të propozuar.

Gjithashtu, kërkesa për paraqitjen e diplomës dhe kontratës së punës ose kontratës së bashkëpunimit ka për qëllim të provojë jo vetëm kualifikimin profesional të specialistit, por edhe disponueshmërinë reale të tij për realizimin e kontratës.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, është proporcional me natyrën e punimeve që do të realizohen dhe nuk cenon parimin e konkurrencës, pasi bazohet në kërkesa të përcaktuara nga legjislacioni sektorial në fuqi dhe synon garantimin e sigurisë publike, mbrojtjen e jetës dhe të pronës.

- c) **1 (një) Punmonjes** që përmbush kriteret për të qenë *“Auditues Energjetik”* në përputhje me kriteret e vendosura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) në Shqipëri, Këto kërkesa bazohen në ligjin nr. 124/2015 "Për Efiçencën e Energjisë" dhe aktet nënligjore përkatëse.

Argumentimi: Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 124/2015 "Për Efiçencën e Energjisë", si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, përfshirja në strukturën teknike të projektit të 1 (një) Inxhinieri i certifikuar si “Auditues Energjetik” sipas kriterëve të vendosura nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) është një kërkesë thelbësore dhe e justifikuar për arsyet e mëposhtme: Detyrim ligjor për ndërtesat publike, Ligji nr. 124/2015 dhe udhëzimet përkatëse parashikojnë që në çdo ndërhyrje ndërtimore që përfshin rikonstruksionin ose rehabilitimin e ndërtesave publike, duhet të merren masa për rritjen e efiçencës energjetike dhe auditimin energjetik, të cilat mund të kryhen vetëm nga persona të licencuar nga AKBN. Përmbushja e standardeve të projektimit të qëndrueshëm. Përmes përfshirjes së Audituesit Energjetik: Realizohet vlerësimi i konsumit aktual dhe parashikimi i kursimeve potenciale. Hartohen masa konkrete për përmirësimin e performancës energjetike të objektit. Sigurohet që zbatimi të jetë në përputhje me standardet europiane për ndërtesat me konsum të ulët energjie (nZEB). Garancia e zbatimit teknik të masave të efiçencës. Audituesi energjetik siguron që zgjidhjet teknike të propozuara (izolim termik, ndriçim LED, sisteme ngrohje-ftohje me efiçencë të lartë, menaxhim automatik energjie etj.): Të jenë të përshtatura me specifikat e objektit. Të jenë të matshme dhe të justifikueshme ekonomikisht. Të kenë impakt pozitiv në reduktimin e konsumit dhe kostove operative afatgjata. Transparencë dhe raportim i besueshëm. Përfshirja e një inxhinieri të certifikuar si auditues energjetik siguron dokumentim teknik të detajuar, raporte zyrtare energjetike dhe monitorim të zbatimit të masave, duke rritur besueshmërinë dhe kontrollin teknik mbi objektin e investimit.

- d) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **1 (një) mjek** të përgjithshëm, ku për përmbushjen e këtij kushti operatori ekonomik ofertues duhet ta deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë të vlefshme pune/ kontratë shërbimi mjeku, Urdhër mjeku, dhe Diplomë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në bashkim që plotëson kriteret e VKM-së Nr.108, datë 09.02.2011 i ndryshuar me VKM-në Nr.632, datë 15.07.2015, duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. OE ofertues referuar Ligjit Nr. 10237, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr. 108 datë 09/02/2011 “Për aftësin që duhet të plotësojnë punëmarrësit personat dhe shërbimet e

specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar, duhet të ketë të paktën një mjek .

- e) **Minimumi 2 (dy)** person të certifikuar per sistemet “CCNA” lëshuar nga organe te akredituar nga Republika e Shqipërisë Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Ligji Nr. 27/2018 “Për sigurinë kibernetike”, neni 6, përcakton detyrimin për përdorimin e personelit të kualifikuar për mbrojtjen e sistemeve të informacionit në infrastrukturën kritike lejon vendosjen e kriterëve të kualifikimit për të garantuar cilësinë e punimeve dhe shërbimeve, për sa kohë ato janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës kerkesa e mesiperme eshte e bazuar ne menyre te rregull me zerat e preventivit dhe kerkesa e mesiperme per kualifikim garanton cilesine dhe zbatimin e rregullt te kontrates referuar zerave te ndryshme te rrjetit kompjuterik dhe Telekomikacionit (Do te pranohet dhe me kontrate shërbimi)

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 2 (dy) specialistë të certifikuar në sistemet “CCNA” (Cisco Certified Network Associate), të pajisur me certifikata të lëshuara nga organizma të akredituar, është vendosur në funksion të garantimit të kapaciteteve profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, në përputhje me natyrën dhe specifikat e objektit të prokurimit.

Objekti i kontratës përfshin zëra punimesh dhe shërbimesh që lidhen me ndërtimin, instalimin, konfigurimin, integrimin dhe funksionimin e rrjeteve kompjuterike dhe sistemeve të telekomunikacionit, për të cilat kërkohet personel i specializuar dhe i certifikuar në administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës së rrjetit.

Kjo kërkesë mbështetet në:

Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili i jep autoritetit kontraktor të drejtën të përcaktojë kriteret kualifikimi të nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës, me qëllim garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë;

Ligjin nr. 27/2018 “Për Sigurinë Kibernetike”, i cili parashikon nevojën për përdorimin e personelit të kualifikuar në administrimin dhe mbrojtjen e sistemeve të informacionit dhe infrastrukturave dixhitale.

Certifikimi CCNA është një certifikim profesional i njohur ndërkombëtarisht, i cili vërteton njohuri dhe aftësi në:

konfigurimin dhe administrimin e rrjeteve LAN/WAN;

instalimin dhe menaxhimin e pajisjeve të rrjetit (router, switch, firewall);

monitorimin dhe diagnostikimin e problemeve të rrjetit;

zbatimin e praktikave bazë të sigurisë së rrjeteve dhe komunikimeve elektronike;

integrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të telekomunikacionit dhe infrastrukturës së transmetimit të të dhënave.

Kërkesa për minimumi dy specialistë është vendosur për të garantuar disponueshmëri të mjaftueshme të personelit teknik gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, si dhe për të

siguruar mbulimin e proceseve të instalimit, konfigurimit, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të parashikuara në preventiv.

Duke qenë se kontrata përfshin zëra specifike të rrjeteve kompjuterike dhe telekomunikacionit, kjo kërkesë është drejtpërdrejt e lidhur me objektin e prokurimit dhe synon garantimin e cilësisë së punimeve, funksionalitetit të sistemeve të instaluara dhe zbatimit të rregullt të kontratës.

Për të mos kufizuar konkurrencën dhe për të respektuar parimin e proporcionalitetit, autoriteti kontraktor do të pranojë që specialistët e kërkuar të jenë të angazhuar pranë operatorit ekonomik edhe nëpërmjet kontratës së shërbimit ose kontratës së bashkëpunimit, përveç marrëdhënies së punës, me kusht që disponueshmëria e tyre gjatë zbatimit të kontratës të provohet me dokumentacionin përkatës ligjor.

- f) **Minimumi 2 (dy)** persona të certifikuar per sistemet “CCTV” lëshuar nga organe të akredituar nga Republika e Shqipërisë Ligji nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” lejon vendosjen e kriterëve të kualifikimit për të garantuar cilësinë e punimeve dhe shërbimeve, për sa kohë ato janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës kerkesa e mesiperme eshte e bazuar ne zerat e preventivit te cilat kerkojne zbatimin e ktyre punimeve te sistemit te kamerave etj. (Do te pranohet dhe me kontrate shërbimi)

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 2 (dy) persona të certifikuar për sistemet CCTV (Closed Circuit Television), të pajisur me certifikata të lëshuara nga organizma të akredituar, është vendosur në funksion të garantimit të kapaciteteve teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin me cilësi të kontratës, në përputhje me natyrën dhe specifikat e objektit të prokurimit.

Kjo kërkesë mbështetet në dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili i njeh autoritetit kontraktor të drejtën për të përcaktuar kriterë kualifikimi që lidhen dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, me qëllim verifikimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë.

Objekti i kontratës përfshin zëra specifike të preventivit që lidhen me furnizimin, instalimin, konfigurimin, testimin dhe vënien në funksion të sistemeve të monitorimit me kamera (CCTV), pajisjeve të regjistrimit, transmetimit dhe administrimit të sinjalit video. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel të specializuar dhe të trajnuar për realizimin e këtyre proceseve sipas standardeve teknike të kërkuara.

Personeli i certifikuar në sistemet CCTV garanton:

instalimin dhe konfigurimin korrekt të kamerave, regjistruarve dhe pajisjeve ndihmëse të sistemit;

integrimin e sistemit të monitorimit me rrjetin e komunikimit dhe infrastrukturën ekzistuese;

kryerjen e testeve dhe verifikimeve funksionale të sistemit;

diagnostikimin dhe zgjidhjen e problematikave teknike gjatë zbatimit dhe vënies në punë të sistemit;

sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të infrastrukturës së monitorimit.

Kërkesa për minimumi dy specialistë është vendosur për të garantuar mbulimin e nevojave operative gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të kontratës, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e punimeve dhe disponueshmërinë e kapaciteteve teknike gjatë gjithë periudhës së realizimit.

Duke qenë se punimet për sistemet CCTV përbëjnë një pjesë të rëndësishme të zërave të preventivit dhe të specifikimeve teknike të projektit, kërkesa për specialistë të certifikuar është drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës dhe synon garantimin e cilësisë, sigurisë dhe funksionalitetit të sistemeve që do të instalohen.

Në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe për të mos kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurë, autoriteti kontraktor do të pranojë që specialistët e kërkuar të jenë të angazhuar pranë operatorit ekonomik edhe nëpërmjet kontratës së shërbimit ose kontratës së bashkëpunimit, me kusht që disponueshmëria e tyre për realizimin e kontratës të provohet me dokumentacionin përkatës ligjor.

- g) **Minimumi 3 (tre)** persona të certifikuar për punime speciale të saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017 lëshuar nga organe të akredituar nga Republika e Shqipërisë Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” lejon vendosjen e kritereve të kualifikimit për të garantuar cilësinë e punimeve dhe shërbimeve, për sa kohë ato janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës kërkesa e mesiperme është e bazuar referuar zërave të preventivit ku kemi të bëjmë me dyert e sigurisë ku standarti I saldimit kërkohej për garantimin e cilësisë në zbatim. (Do të pranohet me kontratë shërbimi)

Argumentimi:

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi 3 (tre) persona të certifikuar për punime speciale saldimit sipas standartit EN ISO 9606-1:2017, të pajisur me certifikata të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituar, është vendosur në funksion të garantimit të kapaciteteve profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin me cilësi të kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet në dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i cili i njeht autoritetit kontraktor të drejtën për të përcaktuar kritere kualifikimi që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe që janë proporcionale me natyrën, kompleksitetin dhe rëndësinë e punimeve që do të realizohen.

Kërkesa është e lidhur ngushtë me zërat e preventivit dhe specifikimet teknike të projektit, të cilat parashikojnë realizimin e punimeve të konstruksioneve metalike dhe montimin e elementëve të sigurisë, përfshirë dyer sigurie dhe elementë të tjerë metalikë, ku cilësia e

saldimeve përbën një faktor thelbësor për garantimin e qëndrueshmërisë, rezistencës mekanike dhe sigurisë së strukturave.

Standardi EN ISO 9606-1:2017 është standard ndërkombëtar i njohur për kualifikimin e saldatorëve në saldimin e materialeve metalike dhe garanton se personeli i certifikuar zotëron njohuritë dhe aftësitë praktike të nevojshme për realizimin e saldimeve sipas kërkesave teknike dhe standardeve të cilësisë në fuqi.

Disponimi i personelit të certifikuar sipas këtij standardi siguron:

realizimin e saldimeve në përputhje me kërkesat teknike të projektit;
garantimin e rezistencës dhe integritetit strukturor të elementëve metalikë;
minimizimin e defekteve gjatë procesit të saldimit;
ritjen e sigurisë dhe jetëgjatësisë së elementëve të instaluar;
respektimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë.

Kërkesa për minimumi 3 (tre) specialistë është vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punimeve të parashikuara, nevojën për realizimin paralel të proceseve të ndryshme të montimit dhe saldimit, si dhe garantimin e vazhdimësisë së punimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe të nxitjes së konkurrencës, autoriteti kontraktor do të pranojë që specialistët e kërkuar të jenë të angazhuar pranë operatorit ekonomik edhe nëpërmjet kontratës së shërbimit ose kontratës së bashkëpunimit, me kusht që disponueshmëria e tyre për realizimin e kontratës të provohet me dokumentacionin përkatës ligjor.

- h) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Librezë pune (përkatëse)
 - CV përkatëse
 - Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi: Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar minimumi:

- Automakinist – jo më pak se **3 (nje)** punonjës
- Shofer – jo më pak se **3 (tre)** punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruara janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të

rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet te perkoje me kerkesat e profilit te deklaruar per cdo punojes.

- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te rregjistruar sipas legjislacionit ne fuqi.

- Gjate fazes se ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit eskavatoriste, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punes, daten e kontrates se punes, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe daten e vlefshmerise se saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere eskavatorist / buldozeristet , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet jane te nevojshem per shkak te makinerive te ndryshme qe do te kryejne punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.7 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjen dja</i>
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10 – 12 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 8-10 ton	1 cope	Pronesi ose me qera

Kamion me vinc mbi 6ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtes min 3.5- 5ton	1 cope	Pronesi ose me qera
Ekskavator me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Minifadrome me goma (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Damper me goma me kapacitet mbajtes 4-6 ton (mjet teknologjik me goma)	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobot uji	1 cope	Pronesi ose me qera
Depozite uji 5000 l	1 cope	Pronesi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronesi ose me qera
Autobetoniere	1 cope	Pronesi ose me qera
Autopompe betoni	1 cope	Pronesi ose me qera
Pompe suvatimi	1 cope	Pronesi ose me qera
Helikopter nivelues	1 cope	Pronesi ose me qera
Armature	min 2000 m ²	Pronesi ose me qera
Betoniere 0.25-0.5 m ³	1 cope	Pronesi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronesi ose me qera
Instrument per punime gjeodezike	1 cope	Pronesi ose me qera

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 40* copë
- Jelek per kantier fosforoshent - *jo më pak se 40*copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 4* copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme– *jo më pak se 4* copë

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruara me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.
- 3- **Për pajisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për pajisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik1” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor

se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatëse në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në disa fronte me duke patur parasysh pozicionimin e objektit, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

Kërkesat për disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve teknike janë vendosur në përputhje me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e kapacitetit teknik dhe operacional të operatorit ekonomik për realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike, afatet e zbatimit dhe standardet e cilësisë të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Mjetet e transportit, përfshirë kamionët vetëshkarkues me kapacitete të ndryshme mbajtëse, kamionin me vinc dhe kamionin me kapacitet mbajtës 3.5–5 ton, janë të domosdoshëm për transportin e materialeve të ndërtimit, elementëve konstruktivë, pajisjeve dhe largimin e materialeve të dala nga proceset e punës, duke garantuar furnizimin e pandërprerë të kantierit dhe realizimin e punimeve sipas grafikut të zbatimit.

Ekskavatori me goma, minifadroma me goma dhe damperi me goma përbëjnë mjete teknologjike të nevojshme për kryerjen e gërmimeve, sistemimin e terrenit, ngarkimin dhe transportin e materialeve brenda kantierit, si dhe për realizimin e proceseve të ndryshme ndërtimore që kërkojnë ndërhyrje mekanike.

Autoboti i ujit dhe depozita e ujit me kapacitet 5000 litra janë të nevojshme për furnizimin me ujë të proceseve ndërtimore, lagjen e sipërfaqeve, kontrollin e pluhurave dhe zhvillimin e punimeve të betonimit dhe suvatimit sipas kërkesave teknike.

Autobetonierja, autopompa e betonit, vibratorët dhe betonierja me kapacitet 0.25–0.5 m³ janë pajisje të domosdoshme për prodhimin, transportin, hedhjen dhe kompaktimin e betonit, duke

garantuar realizimin e elementëve strukturorë sipas parametrave të projektit dhe standardeve të zbatueshme.

Pompa e suvatimit dhe helikopteri nivelues janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të përfundimit dhe trajtimit të sipërfaqeve, duke garantuar cilësi, uniformitet dhe produktivitet më të lartë në procesin e zbatimit.

Armatura me kapacitet minimal 2000 m² është e nevojshme për përgatitjen dhe realizimin e elementëve të betonit të armuar, sipas kërkesave të projektit dhe preventivit të punimeve.

Saldatricja kërkohet për realizimin e punimeve të konstruksioneve metalike, elementëve mbajtës dhe montimeve të ndryshme metalike të parashikuara në projekt, ndërsa instrumenti për punime gjeodezike është i domosdoshëm për kryerjen e matjeve, piketimit, kontrollit të kuotave dhe verifikimin e saktësisë së zbatimit të punimeve sipas projektit teknik.

Kërkesat e mësipërme janë vendosur në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe janë të lidhura drejtpërdrejt me natyrën dhe volumin e punimeve objekt kontrate. Mundësia e disponimit të mjeteve si në pronësi ashtu edhe me qira garanton respektimin e parimit të konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, duke siguruar njëkohësisht që operatori fitues të disponojë kapacitetet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës.

2.3.13 Operatori ekonomik duhet të ketë kontratë me një laborator të akredituar ku të jetë përcaktuar objekti i kontratës/procedurës, për kryerjen e testeve gjatë fazës së zbatimit si dhe përfundimit të objektit. Laboratori duhet të jetë i akredituar për testet e poshtë shënuar, të certifikuar në përputhje me S SH ISO/ICE 17025:2017

Argumentimi Ne baze të nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri AK gjykon se disponimi në pronësi apo me qera i këtyre fabrikave është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kerkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i garantuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave që do të perdoren në punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kerkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kerkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pasi sasia e produkteve që do të perdoren është e konsiderueshme.

2.3.14 Leje mjedisore e keshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për "Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve" më Kod III.2.B

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, ku parashikohet se: "leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të

kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.*

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT